




Kalojmë pushimet “Dorë për Dorë”
Enjoying Holidays “Hand in Hand”



- Mbresat dhe përshypjet në këtë katalog janë bazuar në faksimilet origjinale të shkruara nga fëmijët. Për të përcjellë emocionet ashtu si fëmijët i kanë përjetuar dhe përshkruar gjatë ekperiencës në kamp, nuk është ndërhyrë në gjuhën e përdorur nga to.

The impressions in this catalog are based on the original facsimiles written by the children. To transmit at maximum the experienced emotions and feelings of children in the camp, the language of their notes

- Fotografitë e publikuara në këtë dokument janë marrë gjatë veprimtarive të kampeve verore 2015 organizuar nga rrjeti "Sot për të Ardhmen". Këto fotografi publikohen me aprovimin e të dy palëve: fëmijë dhe prindër.

The published photos in this document, are taken during the activities of 2015 summer camps, organized by the network "Today for the Future". These photos are published with the approval of both, children and parents.

- Duke ruajtur të drejtat e fëmijëve dhe konfidencialitetin, përshypjet e fëmijëve nuk janë bashkëngjitur domosdoshmërisht me foton përkatëse.
Preserving the children's rights and confidentiality, the impressions are not necessarily attached to the relevant photo.

Kalojmë pushimet **“Dorë për Dorë”** *Enjoying Holidays “Hand in Hand”*



Mirënjohje

Rrjeti “Sot për të Ardhmen” shpreh mirënjohjen ndaj partnerit të tij afatgjatë World Vision jo vetëm për bashkëpunimin e vazhdueshëm në ngritjen e kapaciteteve të strukturave komunitare, standarteve të shërbimit në punën me fëmijët, të rinjtë dhe komunitetin, por edhe për mundësimin e aktiviteteve të ndryshme në dobi të grupeve në nevojë. Falenderojmë vullnetarët e rrjetit “Sot për të Ardhmen” për pasionin, dëshirën dhe vullnetarizmin. Të rinjtë e të rejtat, në rolin e lehtësuesve dhe animatorëve kanë dhënë kontribut të përditshëm duke transmetuar dashuri e duke u kujdesur për fëmijët dhe adoleshentët si për motrat dhe vëllezërit e tyre më të vegjël.

Çmojmë mbështetjen dhe bashkëveprimin e mësuesve dhe prindërve në organizimin e gjithë veprimtarisë së kampeve verore.

Një falenderim i vecantë i shkon stafit për profesionalizmin dhe zbatimin e standarteve në edukimin dhe argëtimin cilësor të fëmijëve.

Jemi të lumtur që fëmijët morën pjesë aktivisht në kamp, energjia e tyre u bë motivim për punën tonë në vazhdim.

Gratitudes

“Today for the Future” Network expresses gratitude to his long term partner World Vision, not only for the continuous cooperation in capacity building of community structures, standards of service in working with children, young people and the community, but also for enabling different activities to the benefit of vulnerable groups. We thank the volunteers of “Today for the Future” network for the passion, desire and volunteerism. Volunteers in the role of facilitators and animators have contributed daily giving love and taking care of children and adolescents as their younger siblings.

We appreciate the support and cooperation of teachers and parents in organizing all activities of summer camps.

Special thanks go to the staff for their professionalism and implementation of standards for qualitative education and entertainment of children.

**We are happy that children actively participated in the camp.
Their energy was motivation for our further work.**



Kampi “Dor për Dore” përcolli kaq energji, miqësi e dashuri për njëri-tjetrin sa që të gjithë, fëmijë, adoleshentë, vullnetarë, edukatorë e prindër u ndjemë si një familje e madhe që duhet të ndihmojmë e të përpiqemi për të arrirë një jetë më të mirë, më të bukur e sa më të sigurtë për fëmijët në nevojë. Natyrshëm u ndërthurën jo vetëm argëtimi, lojërat e ndryshme, plazhi, deti, dielli e natyra por edhe edukimi, historia e qytetit, abc-ja e parë, hedhja në letër e mendimeve e ndjenjave të fëmijëve. Prandaj, pas 5 viteve radhazi që Rrjeti i Qendrave Komunitare “Sot për të Ardhmen” organizon kampe verore, u mendua të sillen në një katalog përshtypjet e vetë fëmijëve, që edhe fëmijë e prindër të tjerë të kuptojnë, se si janë ndërë pjesëmarrësit e kampit tonë. Ky është një botim i thjeshtë, por kuptimplotë që sjell emocion e ndjenja të singerta të fëmijëve pjesëmarrës të kampit. Shpresojmë fort që kampet do të jenë një traditë e shkëlqyer e Rrjetit “Sot për të Ardhmen” në vazhdimësi.

.....

“Hand in Hand” Summer Camp spread so much positive energy, friendship and love for each other, that every and each one of us, children, teenagers, volunteers, educators and parents felt like a big family that should help and attempt in achieving a better, nicer and safer life for the children in need. Naturally the camp was a combination of entertainment, various games, going to the beach, physical activity in the nature and of education, learning and discovering the history of the city and writing and expressing the thoughts and feelings of the children. Therefore, after 5 years of organising summer camps, we, the Network of Community Centers “Today for the Future”, thought to gather in a catalog the impressions of the children and to give the opportunity to other parents and children to understand what the participants in our summer camp thought. This is a simple, but meaningful publication, which brings together the thoughts and feelings of the children at the camp. We strongly hope, that our summer camp will be a great tradition of the Network “Today for the Future” and it will keep on persisting for the years to come.

Viola Cikalleshi

Koordinatorë e Kampit / Summer Camp’s Coordinator





Kampi Veror “Dorë për Dorë” është një program edukimi dhe argëtimi që ju ofrua rreth 70 fëmijëve në nevojë të moshave 7-16 vjeç në zonën e Durrësit të Ri gjatë verës. Kampi iu dha mundësinë pjesëmarrësve të mësojnë dhe marrin njohuri të reja, të zhvillojnë aftësitë jetësore dhe sociale, të argëtohen me lojëra dhe të qeshura pafund, aktivitete rekreative pranë detit, sport, këngë, kërcim, etj. Duke prioritetizuar interesin më të lartë të fëmijës dhe duke mbajtur parasysh politikën e mbrojtjes së tyre, fëmijët që nuk kanë mundësi të bëjnë pushime verore, u socializuan së bashku në këtë kamp duke kaluar një kohë të shpenzuar në mënyrë cilësore në një grup edhe me të rinjtë, ku vlerat marrin rëndësi. Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” ka organizuar kampe verore ndër vite, ku në vitet e fundit ka patur një partneritet të suksesshëm me World Vision dhe Caritas St. Polten Austri.

Rreth 1000 fëmijë në nevojë kanë përfituar nga kampet verore të organizuara nga rrjeti “Sot për të Ardhmen” në zona të ndryshme të Shqipërisë si Durrësi, Puka, Tirana, Korça, Elbasani.

Misioni ynë është që fëmijët të jetojnë fëmijërinë e tyre: të ndërtojnë një botë më të mirë, duke i dhënë mundësi të integrohen nëpërmjet arsimit, argëtimit dhe socializimit. Ne shpresojmë se edhe programet afatshkurtra i ndihmojnë për t’u bërë qytetarë të ardhshëm më të përgjegjshëm, profesionistë të rinj dhe njerëz më të ndjeshëm ndaj komunitetit ku jetojnë, me një vizion që shkon përtej realitetit të përditshëm.

Ne besojmë se një tjetër botë është e mundur.

.....
“Hand in Hand” Summer Camp is a program of education and entertainment that was provided for about 70 children in need of ages 7-16 years old in the New Durrës area during the summer. The camp gave the opportunity to participants to learn and acquire new knowledge, develop life and social skills, entertain with games and endless laughter, recreational activities at the sea, sports, singing, dancing etc. Prioritizing the highest interest of the child and taking into account their protection policies, the children that do not have the possibility to go on summer vacation, were brought together in a camp, passing quality time in a group even with youngsters, where values are important. Community Development Center “Today for the Future” has organized summer camps over the years, whereas in the last years we have worked in partnership with World Vision and Caritas St. Polten Austria.

About 1,000 children have benefited from summer camps organized by the network “Today for the Future” in different areas of Albania, like Durrës, Puka, Tirana, Korça, Elbasan. **Our mission is to build a better World for the children, giving them the opportunity to integrate through education, entertainment and socialization.** We hope that even short term programs can help minors become responsible future citizens, new professionals and sensible people of the community where they live, with a vision that goes beyond their everyday reality.


We believe that another World is possible.

Fabiola Laço-Egro

Drejtoresh e Rrjetit “Sot për të Ardhmen” / Director of “Today for the Future” Network



Vendos foton tënde



Në një katalog të vetëm nuk është e mundur të përfshihen të gjithë fëmijët apo të rinjtë pjesëmarrës të kampit “Dorë për Dorë”. Prandaj nëse të bie në dorë ky katalog, ke faqen tënde, ku mund të vësh foton tënde të preferuar të pushimeve si edhe përshtypjet e tua, pavarësisht nëse ke qënë ose jo pjesëmarrës. Katalogun mund ta shkëmbesh me shokun apo shogën tënde dhe të lexosh edhe mesazhin e tij / saj gjithashtu.

In a single catalog it is not possible to include all children or youth participants at the “Hand in Hand” summer camp. So if you will get this catalog, you have your space, where you can put your favorite photo of the vacations as well as your impressions, whether or not you have been a participant. You can swap it with your neighbor or friend to read his / her message as well.

Lër mbresat e tua nga pushimet verore :

Leave you impressions from summer vacation:

.....

.....

.....

.....

.....

.....

Desara

8 vjeç / 8 years

Unë isha me fat që munda të merrja pjesë në Kampin Veror “Dorë për Dore”. Duke e kalu - ar verën në kamp mësova shumë gjëra të reja. Në kamp mësova disa mënyra që të kem kujdes me pastërtin dhe me pamjen time të jashtme. Tani shikoj që e kam më të lehtë të komunikoj me shokët e shoqet, e të fitoj miqësinë e tyre.

I was lucky to be a part of the summer camp “Hand in hand”. I learned a lot of new things. In camp I learned how to take care of my hygiene and my appearance. I find it easier to communicate and win my friends hearts. I even find it easier to express myself and my opinions by participating in discussion groups.





Elvi


8 vjeç / 8 years

Ditët e kampit fluturuan si era. Doja që të zgjaste gjithë verën. Sa mirë sikur të ishte edhe shkolla argëtuese si në kamp. Këtu mu duk vetja si në Diznei. Une vij gjithë vitin në qendër dhe bëj detyrat e shtëpis dhe luajmë. Kam dëshirë që të bëjmë kështu lojrash edhe gjatë vitit. Dua të kthehem përsëri në kamp.

.....

The camp days flew like the wind. I wish it would last all summer long. I also wish school was as entertaining as this camp. I felt like I was in Disney. All year I come here at the centre to do my homework and play. I wish I could play this kind of games all year. I hope I turn back at the camp again next year.





Qelibare

10 vjeç / 10 years

Unë jetoj në një shtëpi të keqe dhe pa drita. Shtëpia është e prishur dhe mami me babin janë pa punë. Ushqim ka pak. Te kampi u ndjeva shumë mirë. Në shtëpi kujdesem për motrat dhe vëllezërit më të vegjël kurse këtu luaja me shoqet. Të gjithë më trajtonin mirë dhe nuk më shanin. Hanim edhe bukë në mëngjes dhe në drekë. Shkonim dhe në plazh. U kënaqa shumë.

.....
I live in a poor house. The house is broken and mom and dad work few. There is little food. I felt very well at the camp. I take care for my little sisters and younger brothers at home. Here I played with my friends. Everyone treated me well and do not insult me. We ate the bread in the morning and at lunch. And we went to the beach. I enjoyed very much.





Fabio

10 vjeç / 10 years

Në kampin “dor për dore” un njofta shumë cuna që jetojnë te lagja ime e un nuk i kisha taku. Zuna shoqni dhe biles edhe me goca. Kjo ishte me e bukura që ndodhi kësë verë. Tani shoqin po e majm edhe jashtë kampit e takohemi edhe mbasditë te lagjia. Them se zuna një miqsi që do zgjasi gjat.

.....

***D**uring the time of “hand in hand” Camp I met a lot of guys who are living in the same neighborhood as me but i had never seen before. I made new friendships with boys and even with girls from the camp. This is the best thing that could’ve happen this summer. Now we hang out with each other even that the camp is over. I think this will be a long lasting friendship.*





Anisa

13 vjeç / 13 years

Mua më pëlqen shumë të punoj gjëra të ndryshme me dorë. Por nuk e dija se mund të krijoj objekte nëpërmjet materialeve pa vlerë. Në kamp kishim një orë të vecantë për riciklimin që më zor e prisnim se kishim për ditë surpriza e nxirrnim nga duart tona cudira të vogla: me letër bëmë varëse dhe portofola, me shishe plastike kam bërë vazo lulesh. Çfarë mësova:

- Nuk do hedh më në kosh asnjë letër të zhgar-ravitur e të keqe.
- Kam filluar edhe të mbledh tapat e shisheve dhe kanaçeve
- Të mbledh gjithë shishet plastike etj dhe do vazhdoj ta bej
- Me letra kam bërë varëse e mbajtëse lapsash Përvec metodave që mësova në kamp, kam edhe disa ide të reja si t'i ripërdor. Në këtë mënyrë kujdesem gjithashtu edhe për mjedisin.



I like very much to do handcrafts. But i didn't know I could create objects with useless things. In camp we had a special recycling/upcycling workshop, we all worked with curiosity and got surprised how could it be possible to create small miracles from our hands: we did necklaces and pencil cases out of recycled paper, flower pots from plastic bottles. What I learned:

- I won't throw away any used letter
 - I have even started to collect the can and bottles tops
 - I have been gathered plastic bottles and I will keep doing:
- Except the methods I learned at the camp, I have some innovative ideas how to re-use them. This way I also take care of the environment.*



Vladimiri

9 vjeç / 9 years

Mua në këtë kamp më ka pëlqyer kur vajtëm në plazh. Luajtëm në rërë e bëmë kala. Pastaj të gjithë shkuam në det e notuam. Këto ditë s'do t'i harroj kurrë, sepse unë mësova notin. Vullnetarët ishin fantastik se s'na bërtisnin si prindërit që kanë frikë se mos mbytemi po na kontrollonin e na e mësuan notin. Ishim rehat dhe mu duk sikur kishim ik me pushime.

.....

The part I liked most from the camp, was when we went to the beach. We played in the sand and made sand castles. Then we swam in the sea all together and swam. I will never forget these days because I learned to swim. The volunteers were fantastic because they didn't hold us back from the fear that we could drown like the parents do, but they controlled us and learnt us to swim. We felt relaxed and it looked to me like if we were on vacations.





Santila

12 vjeç / 12 years



Unë kam qënë edhe më parë pjesë e kampeve verore. Ky ka qënë kampi më i bukur që kam frekuentuar ndonjëherë. Aty u ndjeva si në një shtëpi të madhe. Çdo ditë e më shumë ne u bëmë me njëri –tjetrin si pjesëtarë të familjes. Nuk do të doja të ndryshoja asgjë nga ato që kaluam. Kam ruajtur kujtime shumë të bukura edhe nga ato që mësova edhe nga lojërat që organizuam.

I have been part of other camps and I can say that this is the best camp ever. I felt like we were a part of a big happy home. Every day was better and better, and we were like a happy family. I wouldn't change a thing. I have amazing memories buried in my mind of the games and the things I learned.

Elio

8 vjeç / 8 years



Ne shpeshherë bëjmë sherre dhe i zgjidhim ato duke u zënë. Në kamp kemi diskutuar si të zgjidhim problemet në mënyrë të qytetëru-ar. Kjo gjë do të na hyjë në punë edhe më vonë. Më ka mbetur në mend që ne folëm për prob-lemet që kemi në komunitet. Unë kam dëgjuar më parë biseda të tilla në familje, por askush nuk na kanë pyetur se çfarë me shqetëson. Njo-hu-ritë e reja do t'i përdor në klasën time që ne të ngremë zërin.

We are often in arguments, and we solve them through violence. We have discussed how to solve problems in a civilized manner. This will help us through our lives. What I kept in my mind is our talk about our problems in the community. I have heard discussions about that in our family before, but no one has ever asked what concerns me. I will use my new knowledge in my class we speak my mind.





Ramizi

10 vjeç / 10 years



Kampi ishte si një ditëlindje. Ditën që erdhën animatorët kërcym, kënduam, na bon lojra me gara. Grupi im humbi dhe ne duhet të bënim të gjithë si pula. Të gjithë qeshën. Pastaj na pikturuan futyrën dhe na dhuruan tollombac. Tollombaci im ishte si shpatë dhe lozëm me shokët.

The camp was like a birthday party. One day came animators and we danced, sang, and they did competitive games. My group lose and we had to act like chickens. All laughed. Than they painted our faces and gave us balloons as present. My balloon had the shape of a sword.

Armeli

7 vjeç / 7 years



Unë kam të drejt të luaj. Do të doja që cdo ditë të kaloj si në kamp. Aty organizonim lojra të ndryshme dhe shkonim në plazh. Do të doja që dhe në shkollë të argëtohem më shumë. Gjëja më e bukur në kamp ishte se të mësosh mund të jetë qejf. Duke luajtur mësova si të ndihmoj shokun, si të përdor fjalët magjike, të drejtat e fëmijëve.

I have the right to play. I wish that I spend my day everyday as at the camp. They had organized a lot of games for us and we used to go to the beach. I wish school was as fun as camp. There they showed us that learning can be fun. By playing I learned how to help a friend, how to use the magic words, and learned about children's rights.





Kristo

6 vjeç / 6 years

Unë kam ardhur në këtu për tu argëtu-
ar. Unë kam shumë qef të vizatoj. Në
kamp pikturova me penela që nuk i kam
në shtëpi. Në qendër kishte gjëra të bukura
ngjyra, bojëra dhe tablo ku bëja piktura.

.....
*I came in "in" here to have fun. I like very
much painting. At the camp I painted with
paintbrushes that I don't have at my home.
There were colors, inks, canvas and other
beautiful things where I painted at the cen-
tre..*

KRISTJANO
KARAFILI



UNË KAM ARDHUR
NË KËTU PËR
T'U ARGËTUAR



SI DUHET TË JET

- 1 Sh Kolla duhet të jetë e pastër!
- 2 Sh Kolla duhet të ketë nxënësit të
- 3 Sh Kolla duhet të ketë rregulla!
- 4 Në ShKollë ne duhet të mësojmë shumë!
- 5 Sh Kolla duhet të ketë ambient të pastër!
- 6 Sh Kolla duhet të ketë bukuri!

Eleana

11 vjeç / 11 years



Më pëlqeu shumë kampi! Mësuam gjëra të reja. Nuk u mërzitem asnjëherë. Unë luaja gjithnjë edhe kur isha pak e lodhur. Ndjehem e sigurt dhe më duan. Tani di si të kërkoj të drejtat e mia. Do të doja që kampi të zgjaste edhe më shumë. Mua mu duk sikur ishte vetëm një ditë.

I liked loved the camp! We learned new things every day. We were never bored. I was always part of the games, even when I felt a little tired. I felt safe and loved. I wish the camp lasted more. I felt like it lasted only one day.

Olsi

14 vjeç / 14 years



Un menjen e kam gjithë ditën të .  Pranaj u gzova kur erdha të kampi se do boja lojna e aktivitete argëtive. Ngjofse nuk do vija të kampi, do u mërzitja gjithë verën o nshpi o me cunat që dalim lujm të rruga të dheu afër kanalit. Të lagja ime nuk ka kënd lojnash dhe as park tjetër ku shkojnë kalamajt. Ktu pata munsin tluq ngrup me shok, me shumë ngjyra e me shumë fmi, tshkonim nplazh e ftoj edhe medalje argjendi për lojna popullore.

.....
My mind is at the ball day and night. Therefore I was happy to come in camp because I will play and be part of entertaining activities. If I wouldn't join this camp, my summer would be very boring or at home or out in dust close to the dirty channel playing with guys. In my neighborhood there is no playground or a green park where children can go. Here I had the possibility to play in a friendly environment, full of colors and with a lot of children, to go in beach and to win the argent medal for the folk games.





Mateo
10 vjeç / 10 years

Në kamp u ndjeva shumë i kenaqur. Ushqimi ishte i shishëm dhe organizonim shumë lojra. Loja ime e preferuar dhe që se kisha dëgjuar ndonjëher më parë ishte i verbri dhe shoqëruesi. Ishte qef dhe unë mësova të kem besim te vetja që jam i zoti dhe të kujdesem për njerëzit me aftësi të kufizuar. Në pallat unë kam një grua te vjetër që nuk shetf dhe unë do ta ndihmoj.

I felt very satisfied at the camp. The food was tasteful and there were a lot of games. The game which I didn't know before, was blind and companion. It was fun and I learned to trust in myself that I am able to take care of disabled people. In my building there is an old blind women that I will help.

Eriona

15 vjeç / 15 years



Ky ishte një kamp magjik. Kur kthehesha nga kampi, unë shkoja në shtëpi me vrap dhe s'më pushonte goja gjithë ditën duke i treguar prindërve, motrave, kushërirave çfarë bëmë në kamp. Këtu unë mora mësimet të vlefshme për jetën. Tani më duket vetja si më e rritur. Unë do të dëshiroja që të jem pjesë e kampit edhe vitin tjetër.

This was a magical camp. When I returned from the camp, I run home and my mouth didn't cease telling the parents, sisters and cousins what we did at the camp. Here I learned useful lessons for my life. Now I feel like I am an adult. I wish I would join the camp even next year.





Besime

9 vjeç / 9 years

U bënë vite që unë jetoj në Durrës bashkë me familjen time, por zona ku jetoj është shumë larg qendrës së qytetit. Mami dhe babi rrallë e kanë patur mundësinë të na nxjerrin shëtitje në Vollga pasdite. Unë nuk dija asgjë për historinë e Durrësit. Një ditë gjatë kampit, ne bëmë një shëtitje ku vizituam disa vende në qytet si muzeun, amfiteatrin e monumente të tjera. Jam e lumtur që tani di më shumë rreth vendit ku banoj. Dua që këto gjëra t'ia tregoj edhe shokëve e shoqeve të klasës kur të fillojë shkolla.

.....

I've been living in Durres with my family for years, but the area where I live is far from the city center. Mom and Dad rarely had the chance to walk us out on the Volga in the afternoon. I knew nothing about the history of Durrës. One day during the camp, we took a walk and visited several places in the city as the museum, amphitheater and other monuments. I am happy that now I know more about the city where I live. I want to show this to all of my classmates when school starts.





Leonardi

15 vjeç / 15 years

Përditë te kampi ne e myllnim duke kërcy e knu. Un knova kong rome. Do bohem këngtar kur trritem. Kto konget do ja msoj edhe shokut tim tngusht edhe kushuririt tim që ta knojm të tre dhe ta shoqrojm me daulle dhe dajre. Presori muzikës ishte i modh fare dhe na msoi si ti bim edhe veglave. Du që kampi mos maroi asihet.

.....

Every day we closed with dancing and singing. I sang roma songs. I want to be a singer when I grow up. I taught a roma song to my bestfriend and my cousin so we will sing it all together with drums and tambourine. The music teacher was cool and taught us to play music instruments. I don't want the camp to finish.





Megi

15 vjeç / 15 years

Unë në kamp u ndieva shumë mirë sepse e kalonim ditën plot me aventura. Unë përfshihesha në të gjitha aktivitetet, e prandaj u zgjodha liderja e grupit. Kampi më ka bërë të ndjem përgjegjëse jo vetëm për vete por edhe për shokët. Kam dhënë edhe një intervistë në televizion ku tregova eksperiencën time në kamp. Dhe kjo ishte një eksperiencë e paharrueshme.

I felt very good at the camp because we went through adventures every day. I got involved in every activity, so I was even chosen as the team captain. The camp taught me to be responsible not only for myself but even for my friends. This was an unforgettable experience.

Xhensila

12 vjeç / 12 years



Edukatorja na thoshte që cdo fëmijë meriton një fillim të mirë në jetë. Ne diskutuam si duhet të jetë vendi ku jetojmë që të jemi të lumtur. Kampi ishte vendi perfekt. U ndjeva e lumtur me shoqet e mia. Aktivitetet na kënaqën. Bëmë shumë biseda edhe për të drejtat tona. Për herë të parë u ndjemë të gjithë të barabartë. U bëmë një grup miqësor që do ndihmojmë njëri-tjetrin edhe në të ardhmen.

The teacher told us that every child deserves to have a good start in life. We discussed how showed be the place where we live to make us happy. The camp was the perfect place. I felt happy with my friends. The activities were very pleasing. We has a lot of conversations about our rights. For the first time we felt all equal. We became a friendly group who will help each other even in the future.





Kevi

15 vjeç / 15 years

Nuk them dot sa gjëra do mbaj mend nga kampi. Por di të them që do të jetë i paharrueshëm. Unë mora pjesë në kampin për adoleshtët dhe shpreha dëshirën të bëhem vullnetar. Kështu bashkë me disa shokë e shoqe të tjera ndihmuam tek kampi i fëmijëve. Unë përvecse ndihmoja në organizimin e aktiviteteve, në kohën e ngrënies kisha edhe përgjegjësi për të shërbyer ushqimin. Mësova të bëj punë dhe të respektoj rregulla. Ne na ndihmonin shumë edhe vullnetarët më të mëdhenj. Mendoj që në

të ardhmen të angazhohem prapë si vullnetar për të ndihmuar njerëz që kanë nevojë. Ishte kamp i shkëlqyer.

I could not say how many things I will remember from the camp. But I can say that I will be unforgettable. I attended the camp for adolescents and expressed the wish to become a volunteer. So with some other friends we helped at the children's camp. Unless helping in organizing activities, I also helped during mealtimes and had the responsibility to serve the food. I have learned to work and respect rules. The older volunteers also helped us a lot. I think that in the future I will be engaged again as a volunteer to help people in need. The camp was excellent.



“Sot për të Ardhmen” është rrjet lider në Shqipëri për mobilizim dhe fuqizim të komuniteteve në nevojë. Udhëhequr nga vizioni dhe duke përdorur metoda inovative dhe gjithëpërfshirëse, “Sot për të Ardhmen” ka krijuar përjasje të suksesshme të fuqizimit gjinor; vullnetarizmit; aktivizmit; mbrojtjes së mjedisit; ndërmjetësimit për punësim; shërbimeve; përfshirjes dhe mobilizimit komunitar, në partneritet të ngushtë me qeverisjen qendrore dhe vendore, agjensitë kombëtare dhe ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe sektorin privat.

“Today for the Future” is a leading organization in Albania for mobilization and empowerment of marginalized communities. Driven by a great vision and by using innovative methods, “Today for the Future” has scored successful approaches in gender empowerment, voluntarism, activism, environment protection, employment mediation, community services, as well as in participation and community mobilization. “Today for the Future” works in close cooperation with the local government, national and international agencies as well as the civil society and private sector.

Ky katalog u realizua me mbështetjen dhe partneritetin e World Vision, në kuadër të Kampit Veror “Dorë për Dorë” për fëmijët dhe të rinjtë. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e rrjetit për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen” dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e World Vision.

This catalog was implemented with the support and partnership of World Vision, in the frame of “Hand in Hand” Summer Camp for children and young people. The content is the sole responsibility of the Community Development Network “Today for the Future” and does not necessarily represent the views of World Vision.



RRJETI PËR ZHVILLIM KOMUNITAR "SOT PER TE ARDHMEN"

L.17, Rr. Rinia Durrsake, skolina 5, ish-Kënetë, Durrës, Shqipëri Rr. Elbasanit, Pallatet Abau, Shkalla 2, Kati 6, Ap. 13, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 69 40 94 622 / Fax: +355 230 2410 / info@cdc-tff.org / <http://www.cdc-tff.org>

Rrjeti i reagimit kundër dhunës / Nr. i Gjellbër: 0800 98 88

COMMUNITY DEVELOPMENT NETWORK "TODAY FOR THE FUTURE"

L.17, Rr. Rinia Durrsake, skolina 5, ish-Kënetë, Durrës, Shqipëri Rr. Elbasanit, Pallatet Abau, Shkalla 2, Kati 6, Ap. 13, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 69 40 94 622 / Fax: +355 230 2410 / info@cdc-tff.org / <http://www.cdc-tff.org>

Coordinated Network for Reaction Against Violence / Green number: 0800 98 88

ISBN: 978 - 9928 - 4302 - 0 - 5



9 789928 430205